



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

BISEDIME PËRFUNDIMTARE

“Në lidhje me çështjen Nr. (JR) 27/2024, që i përket subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni”

Kërkues/Apelues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga Drejtuesi i Prokurorisë **z. Altin Dumani**, si dhe nga prokurori **z. Adnan Xholi** (me autorizim).

Objekti: Bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në seancë gjyqësore, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit me Nr. 754, datë 5.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Data e seancës: **19.3.2025.**

Përpara: **Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese**

E nderuar znj. kryesuese e Trupit Gjykues!

Të nderuar gjyqtarë, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe prapësimet e palëve, si dhe provat e administruara në kuadër të këtij gjykimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 10.7.2024 dhe parashtrimeve të datës 13.3.2025, në mënyrë të përmbledhur, vlerëson se:

I. LIDHUR ME VLERËSIMIN E KRITERIT TË PASURISË

1. *Apartament banimi me sip. 111.6 m², ndodhur në Vlorë.*

1.1 Lidhur me pasurinë “*Apartament banimi me sip. 111.6 m²*”, vlerësojmë se, edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 10.7.2024 dhe në parashtrimet e datës 13.3.2025, lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie.

1.1.1 Subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, lidhur me burimet e krijimit të pasurisë “*Apartament banimi me sip. 111.6 m²*”, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe nuk ka paraqitur akte të reja për të provuar të kundërtën e shkaqeve të ankimit¹.

1.1.2 Fillimisht çmujmë të risjellim në vëmendje të Kolegjit se, si kontrata e kaparit e datës **.5.2006, ku subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e blerëses së ardhshme, ashtu edhe të gjithë mandatpagesat e administruara për pagesat e kryera për pasurinë apartament me sip. 111.6 m², janë nënshkruar vetëm nga subjekti i rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni. Rezulton se znj. Mirela Mishgjoni, ka mbajtur funksionin e gjyqtares për disa vite përpara blerjes së kësaj pasurie dhe ka deklaruar se ka bashkëjetuar me z. *** ** që prej vitit 2005.

1.2 *Lidhur me të ardhurat e z. *** ** nga shitja e shoqërisë “****” S.N.C.*, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj nga shitja e kësaj shoqërie, plotësojnë kërkesat e ligjit për tu konsideruar të ardhura të ligjshme në kuadër të këtij procesi dhe 80% e tyre duhet të përfshihen si të ardhura të ligjshme të përfituara nga bashkëshorti.

1.2.1 **Drejtuasi i Prokurorisë së Posaçme**, lidhur me të ardhurat e z. *** ** nga shitja e shoqërisë “****” ***.***.***., ashtu sikurse është trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 10.7.2024 dhe në parashtrimet e datës 13.3.2025, vlerëson se në nenin D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, parashikohet qartë se pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Në rastin konkret, rezulton se shlyerja e detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura ka nisur nga data **.11.2023, kur për subjektin kishte filluar procesi i rivlerësimit. *Pra, detyrimet tatimore kanë nisur të paguhen me vonesë dhe për efekt të procesit të rivlerësimit, dhe si rezultat këto të ardhura nuk duhet të përfshihen në analizën financiare.*

1.2.2 Por, referuar akteve të administruara gjatë hetimit administrativ², lidhur me shitjen e shoqërisë “****” S.N.C., rezulton se një pjesë e të ardhurave nga shitja e shoqërisë do të shlyejej nëpërmjet kambialeve përgjatë periudhës **.7.2004–**.9.2009, ndërkohë që

¹ Subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore të datës 13.3.2025, ka paraqitur vetëm shkresën nr.***/* prot., datë **.4.2024, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, që referon se punishtja e vajit ndodhur në ***, Vlorë, nuk rezulton e regjistruar në regjistrat kadastralë.

² Referohuni aktit të nënshkruar me shoqërinë *** ** * datë **.7.2004, të administruar në dosjen e Komisionit.

rezulton se deri në datë **.8.2006, nga çmimi total i apartamentit janë shlyer 54.000 euro dhe si rezultat kambialet e likuiduara pas kësaj date nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për shlyerjen e këtyre pagesave të apartamentit.

1.2.3 Sa i takon pretendimit të subjektit, se nga shitja e kësaj shoqërie bashkëshorti i saj ka përfituar 80% të vlerës së shitjes ose rreth 108.000 euro, referuar akteve të administruara në dosje, rezulton se, përveç se ky pretendim nuk mbështet në asnjë nga aktet noteriale të kohës të nënshkruara për shitjen e kësaj shoqërie, pretendimi i subjektit bie ndesh dhe me sa është deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën *Vetting* lidhur me të ardhurat nga shitja e saj.

1.2.4 Konkretisht në deklaratën *Vetting* personi i lidhur, z. *** ***, ka deklaruar të ardhura nga emigracioni në Itali per periudhen 1992-2005, (i) të ardhura të siguruar nga punësimi në mënyrë të ligjshme, (ii) punësimi si punonjës i pasiguruar, (iii) si dhe nga shitja e një restoranti ne Itali në vitin 2004, në total në shumën rreth 123.000 euro.

1.2.5 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ lidhur me të ardhurat e përfituara nga punësimi i z. *** *** në shtetin Italian, ka rezultuar se të ardhurat sipas vërtetimit të INSP-në, (Istituto Nazionale Provedenza Sociale) për periudhën 1996-2005 janë në vlerën 36.822 euro, ndërsa të ardhurat bruto sipas agjensisë së tatimeve për të njëjtën periudhë janë në vlerën rreth 67.000 euro. Nëse nga shuma totale 123.000 euro që është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në deklaratën *Vetting*, do të zbrisnim secilën prej këtyre vlerave të të ardhurave, në asnjë rast diferenca e mbetur nuk do të ishte në shumën 108.000 euro, sikurse pretendon subjekti i rivlerësimit. Për më tepër që bashkëshorti i subjektit deklaroi se pjesë e shumës 123.000 euro janë dhe të ardhurat nga punësimi si punonjës i pasiguruar, vlera e të cilave nuk identifikohet.

1.2.6 Deklarata noteriale e datës **.3.2023 e shtetasit *** ***, e depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ për të provuar se bashkëshorti i saj ka përfituar 80% të vlerës së shitjes së shoqërisë, është një deklaratë e hartuar gjatë hetimit administrativ, për efekt të këtij procesi. Kjo deklaratë e depozituar nga subjekti në funksion të deklarimeve të saj gjatë procesit të rivlerësimit, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, merret me rezervë në këtë proces.

1.2.7 Sa më sipër, lidhur me të ardhurat e z. *** *** nga shitja e shoqërisë “****” S.N.C., vlerësojmë se këto të ardhura nuk plotësojnë kushtet e nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe si të tilla nuk duhen përfshirë në analizën financiare. Për më tepër rezulton se një pjesë e këtyre të ardhurave duket të jetë përfituar pas kryerjes së pagesave të apartmentit nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu nuk provohet pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nga shitja e kësaj shoqërie bashkëshorti i saj ka përfituar 80% të vlerës së shitjes.

1.3 Lidhur me të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit të subjektit në Itali, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera, ka deklaruar se, të

ardhurat e përfituara nga punësimi në Itali i bashkëshortit për periudhën 1998-2004 janë në vlerën 67.319 euro, si dhe ka pretenduar se mundësia për kursim në vlerën 36.185 euro duhet përfshirë si e ardhur e ligjshme e përfitur nga bashkëshorti.

1.3.1 **Drejtuksi i Prokurorisë së Posaçme**, lidhur me të ardhurat e z. *** nga punësimi në Itali, ashtu sikurse është trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 10.7.2024 dhe në parashtrimet e datës 13.3.2025, vlerëson se nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton mundësi kursimi nga këto të ardhura dhe si rezultat këto të ardhura nuk duhen përfshirë në analizën financiare.

1.3.2 Së pari theksojmë se të ardhurat në vlerën 67.319 euro, sikurse dhe Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij, nuk përfaqësojnë të ardhurën neto, dhe janë të ndryshme dhe nga të ardhurat e bashkëshortit sipas vërtetimit të INSP-në (Istituto Nazionale Provedenza Sociale), që rezultojnë në vlerën 36.822 euro³.

1.3.3 Gjithashtu, vlerësojmë se shpenzimet e jetesës për personin e lidhur në shtetin Italian duhen llogaritur sipas standartit tashmë të konsoliduar të institucioneve të rivlerësimit⁴ që referuar të dhënave të Eurostat për periudhën 1996 deri në *.5.2005, llogariten në vlerën rreth 57.000 euro.

1.3.4 Përveç shpenzimeve të jetesës si më sipër, referuar aktit noterial të noterit *** datë *.7.2004, të administruar në dosje, rezulton se kapitali aksionar i shoqërisë “***” ***, është në vlerën 2.000 euro, nga ku vlera e pjesës takuese 50% të bashkëshortit të subjektit llogaritet në shumën 1.000 euro. Ndërsa referuar aktit paraprak të shitjes së shoqërisë datë *.2.2004 rezulton se nga çmimi fillestar prej 87.798 euro që z. *** dhe *** e kanë blerë këtë shoqëri në vitin 2002, shuma 68.427 euro është borxhi i mbetur pa shlyer kundrejt shitësit deri në këtë datë. Pra nga çmimi fillestar i blerjes rezulton që deri në datën *.2.2004 janë shlyer në total nga z. *** dhe ***, 19.371 euro (87.798 euro – 68.427 euro), nga ku pagesat e kryera nga bashkëshorti i subjektit llogariten në vlerën 9.685 euro.

1.3.5 Sa më sipër, rezulton se edhe në variantin që marrim në konsideratë të ardhurat e përfituara nga z. *** në masën që pretendon subjekti i rivlerësimit (që përfaqësojnë të ardhurat bruto), pas zbritjes së shpenzimeve të jetesës dhe shpenzimeve/investimeve të kryera për shoqërinë “***” S.N.C., nuk do të rezultonte mundësi kursimi nga këto të ardhura të realizuara nga bashkëshorti i subjektit nga punësimi në shtetin Italian.

1.4 *Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti restorator, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se,*

³ Referohuni analizës financiare të Komisionit në tabelën nr. 5, f. 10 e rezultateve të hetimit.

⁴ Referohuni analizën financiare të Komisionit të administruar në dosjen hetimore, zërit *Shpenzimet jetike eurostat 60% threshold*.

të ardhurat e realizuara nga punësimi i bashkëshortit gjatë periudhës **.6.2005 – **.12.2010, plotësojnë kërkesat e ligjit për tu konsideruar të ardhura të ligjshme në kuadër të këtij procesi.

1.4.1 **Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme**, lidhur me të ardhurat e z. *** ** nga aktiviteti ristorator gjatë periudhës 2005 – 2011, deklaruar në deklaratën Vetting, në shumën rreth 5.400.000 lekë (për të gjithë periudhën), vlerëson se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk u administrua asnjë akt i kohës si kontratë pune, listëpagesë, kreditim i pagës në llogarinë bankare të përfituesit etj., që të provojë përfitimin faktik të këtyre shumave, kohën e përfitimit ose shumën përkatëse dhe si rezultat nuk duhen përfshirë në analizën financiare.

1.4.2 Gjithashtu, konstatojmë se edhe pse në deklaratën Vetting dhe në deklaratat periodike vjetore për vitet 2009-2011 kërkohet specifikisht që të përshkruhet hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, nuk rezulton që në këto deklarata subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur të kenë deklaruar/specifikuar se të ardhurat nga aktiviteti si ristorator janë përfituar nga punësimi pranë punëdhënësve, “*** **”, “***” sh.p.k., apo “*** **”.

1.4.2.1 Të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur në deklaratën Vetting, në shumën 5.400.000 lekë, janë të ndryshme nga shuma e përlllogaritur nga Komisioni bazuar në deklaratat noteriale të hartuara gjatë hetimit administrativ nga përfaqësuesit e këtyre shoqërive që rezulton të jetë rreth 6.400.000 lekë.

1.4.2.2 Në deklaratën para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI në datë **.3.2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit *** ** nga aktiviteti privat për periudhën janar deri në **.2.2009 në shumën 350.000 lekë.

1.4.2.3 Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2009 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit nga aktiviteti si ristorator në shumën 2.450.000 lekë. Kjo shumë nuk përputhet me shumën e deklaruar si të përfituar nga Personi Fizik, “*** **”, që sipas pohimit gjyqësor të referuar në vendimin nr. ***/2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është në shumën 1.000.000 lekë/vit.

1.4.2.4 Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit nga aktiviteti si ristorator në shumën 1.400.000 lekë. Edhe në këtë rast shuma e deklaruar nga subjekti nuk përputhet me shumën e deklaruar si të përfituar nga Personi Fizik, “*** **”, që sipas pohimit gjyqësor të referuar në vendimin nr. ***/2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është në shumën 1.000.000 lekë/vit.

1.4.2.5 Përveç sa më sipër, vërejmë se bashkëlidhur deklaratës Vetting subjekti i rivlerësimit ka depozituar dhe kontratën e qirasë nr.*** rep., dhe nr.*** kol., datë **.10.2007, nënshkruar ndërmjet shtetasës *** ** në cilësinë e qiradhënëses dhe *** e

*** ** në cilësinë e qiramarrësve. Objekt i kësaj kontrate është dhënia me qira e një lokali me sipërfaqe 400 m², ndodhur në lagjën “**** **”, Vlorë nga data **.11.2007 - **.11.2012. Vlera e qirasë sipas kontratës është përcaktuar në shumën 1.000 euro/muaj deri në datën **.11.2009 dhe nga data **.11.2009 – **.11.2012 do të jetë 1.250 euro/muaj. Kjo kontratë është nënshkruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. *** **.

1.4.2.6 Subjekti i rivlerësimit e pyetur nga Komisioni lidhur me këtë kontratë qiraje në përgjigje të pyetësorit nr.3, ndër të tjera ka deklaruar: [...] *bashkëshorti ka menduar të hapte një aktivitet privat dhe ky ka qenë qëllimi i lidhjes së kontratës nr. ***/**, datë **.10.2007 ... Për më tepër, aktiviteti nuk pati rezultat pozitiv. Xhiro e realizuar nuk arrinte të mbulonte as shpenzimet operacionale ... **Bashkëshorti ka ushtruar këtë aktivitet vetëm për dy sezone verore** dhe si pasojë e rezultateve financiare ... ky aktivitet nuk ka vazhduar më tej [...].*

1.4.3 Sa më sipër, konstatojmë se nuk është administruar asnjë akt i kohës që të provojë punësimin pranë punëdhënësve “**** **”, “****” sh.p.k., apo “**** **”. Gjithashtu, shumat e këtyre të ardhurave të deklaruara në deklaratat periodike vjetore dhe atë *Vetting* janë të ndryshme me sa deklarohet në deklaratat noteriale të punëdhënësve të hartuara gjatë hetimit administrativ.

1.4.4 Sa më sipër, marrë në konsideratë dhe rrethanat e cituara në kontratën e qirasë që është depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, si dhe duke marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr.3 lidhur me këtë kontratë qiraje dhe me aktivitetin e ushtruar nga bashkëshorti i saj në këto vite, vlerësojmë se, nuk u provua punësimi i bashkëshortit të subjektit pranë shoqërive “**** **”, “****” sh.p.k., apo “**** **”. Pretendimet e subjektit nuk përputhen me sa deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore dhe si rezultat këto të ardhura nuk duhen përfshirë në analizë financiare.

1.4.5 Përveç sa më sipër, vlerësojmë se këto të ardhura nuk duhet të përfshihen në analizën financiare, dhe në konsideratë të qëndrimit orientues të Kolegjit⁵, se duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera.

1.4.6 Lidhur me pretendimin e subjektit, se bashkëshorti ka ardhur në dijeni për mosshlyerjen e detyrimeve tatimore vetëm gjatë procesit dhe ka kërkuar gjyqësisht që punëdhënësit të zbatojnë detyrimet ligjore, vërejmë se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit bie ndesh me sa deklaruar prej saj gjatë hetimit administrativ të Komisionit, pasi rezultoi se në përgjigje të pyetjes nr.8 të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera, ka deklaruar [...] *Si është sqaruar dhe më sipër detyrimin për të deklaruar pagat reale dhe pagësen e detyrimeve tatimore e sigurimeve shoqërore e kishin*

⁵ Referuar Vendimit (JR) të Kolegjit nr. 15/2021.

punëdhënësit e tij. Në pozicionin që kishte dhe në realitetin e asaj kohe ai e ka kërkuar disa herë por punësimi i tij nuk është deklaruar [...].

1.4.7 Sa më sipër, sikurse dhe Kolegji ka trajtuar në jurisprudencën e tij, në situata të ngjashme⁶, vlerësojmë se përpjekja për të arritur te pagesa e detyrimeve tatimore, gjatë procesit, është vlerësuar se përfaqëson veprime të kryera për efekt të këtij procesi dhe në kushtet kur këto të ardhura nuk mbështen nga akte të kohës, nuk duhen marrë në konsideratë në analizën financiare.

1.5 *Lidhur me të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga personi i lidhur nga akt –marrëveshja e shitjes së pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit Vlorë, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegji, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera ka deklaruar se të ardhurat e përfituara nga shitja e pjesës takuese në punishten e vajit, plotësojnë kërkesat e ligjit për tu konsideruar të ardhura të ligjshme në kuadër të këtij procesi.*

1.5.1 **Drejtuksi i Prokurorisë së Posaçme**, lidhur me këto të ardhura ashtu sikurse është trajtuar në ankimin e datës 10.7.2024 dhe në parashtrimet e datës 13.3.2025, vlerëson se këto të ardhura nuk duhet të përfshihen në analizën financiare dhe nuk duhen marrë në konsideratë në vlerësim tërësor, pasi përveçse nuk janë deklaruar në deklaratën “*Vetting*” dhe në deklaratat periodike vjetore si të ardhura apo si burim krijimi, nuk plotësojnë dhe kriteret e nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, ku është parashikuar qartësisht se pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Gjithashtu rezulton se pas nënshkrimit të kësaj akt-marrëveshje nga z. *** *** në datën **.2.1997, nuk është administruar ndonjë akt i kohës që të provojë posedimin e kësaj shume në vitet pasuese.

1.6 Përveç sa më sipër, nga aktet e administruara gjatë hetimit në Komision rezulton se të ardhurat nga aktiviteti si ristorator i bashkëshortit dhe nga aktiviteti si avokate i subjektit, janë deklaruar si burim krijimi jo vetëm për blerjen e pasurisë apartament në vlerën 60.000 euro, por dhe si burim krijimi të pasurive: (i) Depozitë bankare në bankën ***, krijuar në datën **.6.2008, në vlerën 1.013.500 lekë; (ii) Autoveturë tip “Daimler Chrysler” blerë në datë **.1.2008 në shumën 500.000 lekë; (iii) Huadhënien në shumën 17.000 euro dhënë motrës së subjektit në vitin 2008; (iv) Kursime në shumën 70.000 euro, të deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës; (v) Huadhënie shtetasit ***.***., në shumën 3.000.000 lekë⁷.

1.7 Në total rezulton se pasuritë/huadhëniet e mësipërme të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur me të, në deklaratën para fillimit të detyrës me burim të

⁶ Referuar Vendimit (JR) të Kolegjit nr. 23/2020.

⁷ Referohuni deklarimeve të subjektit në deklaratën para fillimit të detyrës dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2009. Në deklaratën para fillimit të detyrës është deklaruar vetëm huadhënie në emër të shtetasit ***.***., pa deklaruar shumën ndërsa gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se nga kursimet e *** *** shtetasit *** *** dhe *** *** kanë përdorur shumën 3.000.000 lekë dhe se me lidhjen e martesës bashkëshorti ka kërkuar kthimin e kësaj shume.

ardhurat nga aktiviteti si ristorator i bashkëshortit dhe nga aktiviteti si avokate i subjektit rezultojnë në vlerën rreth 147.000 euro dhe rreth 4.500.000 lekë, pa përfshirë këtu shpenzime jetese apo shpenzime të tjera të bëra gjatë kësaj periudhe.

1.8 Në përfundim, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, datë 28.6.2024, vlerësojmë se, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit, lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 111.6 m², ndodhur në Vlorë, duke u gjendur në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, sipas nenit 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

2 Tokë bujqësore, deklaruar nga personi i lidhur, z. * ***.**

2.1 Lidhur me pasuritë tokë bujqësore me sipërfaqe totale 15.560 m², ndodhur në ***, Vlorë, vlerësojmë se edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 10.7.2024 dhe në parashtrimet e datës 13.3.2025.

2.2 Subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, lidhur me këtë shkak ankimi, ndër të tjera ka deklaruar se konkluzioni i Komisionerit lidhur me këto pasuri është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar. Gjithashtu subjekti në seancën gjyqësore të datës **.3.2025 ndër të tjera ka depozituar aktet si vijon: (i) VKM të viteve 2008, 2013, 2014 dhe 2016 ku referohet ndër të tjera vlera e tokës bujqësore në fshatin ***, Vlorë, për vitet respektive⁸; (ii) disa deklarata noteriale të shitësve të tokave në ***, Vlorë⁹, ku këta të fundit deklarojnë se i kanë shitur shtetasit *** *** tokën për vlerën 50 lekë/m²; (iii) kartelat e këtyre pasurive të ndodhura në ***, Vlorë¹⁰, në pronësi të shtetasit *** ***.

2.3 **Drejtuuesi i Prokurorisë së Posaçme**, referuar akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 13.3.2025, vlerëson se:

2.3.1 Subjekti i rivlerësimit edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj nuk arriti të shpjegojë bindshëm arsyen e blerjes së këtyre tokave me një çmim disa herë më të ulët se çmimi minimal i referencës fiskale. Vlera totale e pasurive tokë bujqësore “Arë”, sipas çmimit minimal të referencës fiskale, rezulton në vlerën 6.367.356 lekë, ndërsa bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i ka blerë këto pasuri në vlerën 1.061.600 lekë.

⁸ VKM nr.139, datë 13.2.2008; VKM nr.187, datë 6.3.2013; VKM nr.514, datë 30.7.2014, VKM nr.89, datë 3.2.2016.

⁹ Deklaratë noteriale nr.*** rep., dhe nr.***, kol., datë **.2.2025; Deklaratë noteriale nr.*** rep., dhe nr.***, kol., datë **.2.2025; Deklaratë noteriale nr.*** rep., dhe nr.***, kol., datë **.2.2025; Deklaratë noteriale nr.*** rep., dhe nr.***, kol., datë **.2.2025. Gjithashtu subjekti ka depozituar dhe dy certifikata vdekje të shtetasve ***.***, dhe ***.***, të dhëna nga sistemi TIMS, për disa nga shitësat që ndodhen jashtë vendit si dhe akte vlerësimi të vlerësuesit privat *** *** për këto toka bujqësore.

¹⁰ Kartelë e pasurisë së paluajtshme me kod unik ***, datë **.2.2025, Kartelë e pasurisë së paluajtshme me kod unik ***, datë **.2.2025; Kartelë e pasurisë së paluajtshme me kod unik ***, datë **.2.2025; Kartelë e pasurisë së paluajtshme me kod unik ***, datë **.2.2025; Kartelë e pasurisë së paluajtshme me kod unik ***, datë **.2.2025.

2.3.2 Konstatohet se dhe në VKM-të e depozituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, rezultojnë se çmimi i tokave bujqësore në ***, Vlorë, varion nga 406 lekë/m² në vitin 2008 në 204 lekë/m² në vitin 2016. Ky çmim krahasuar me çmimin e paguar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit që në 4 (katër) nga kontratat e shitblerjes është në vlerën 60 lekë/m², ndërsa në njërin prej tyre është në vlerën 100 lekë/m², përsëri rezultojnë se është disa herë më i lartë se ai i paguar nga bashkëshorti i subjektit.

2.3.3 Subjekti i rivlerësimit edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj nuk ka paraqitur akte noteriare të kohës apo transaksionet financiare për të provuar sa ka qenë çmimi i blerjes së këtyre tokave nga kunati i saj në vitet respektive. Deklaratat noteriare të disa prej shitësve, të depozituara nga subjekti në seancën e datës 13.3.2025, duket se janë akte të hartuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, për efekt të këtij procesi dhe si të tilla duhen marrë me rezervë për sa deklarohet në to. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të paraqesë shpjegime bindëse se përse kunati i saj në cilësinë e përfaqësuesit të palës shitëse, i ka shitur këto pasuri tek bashkëshorti i subjektit, një prej të cilave vetëm një ditë pas hartimit të aktit të përfaqësimit/prokurës së posaçme, me palën shitëse.

2.3.4 Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni¹¹, si dhe bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, vërejmë se, ***nëse në analizën financiare të viteve kur janë blerë këto pasuri, do të përfshihej si investim çmimi i referencës i cituar në kontratat e shitblerjes së këtyre pasurive***, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur ***do të rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme për vitet 2010 dhe 2012***¹² dhe si pasojë konkluzioni në lidhje me këto pasuri do të ishte i ndryshëm.

2.3.5 Referuar kartelave të këtyre pasurive të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, nuk rezultojnë që mbi këto pasuri të ketë ndërtesa të regjistruara, por nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur akte për të provuar sa është vlera e investimit/shpenzimit të kryer për krijimin e vreshtarisë në tre prej këtyre tokave bujqësore me sipërfaqe totale 6.700 m² dhe nga kush është kryer ky investim. Pretendimi i subjektit se shpenzimet për vreshtarinë në këto toka bujqësore janë kryer nga shtetasi *** *** mbetet në nivel deklarativ dhe nuk gjen mbështetje në aktet e administruara.

2.3.6 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në Deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore, ekzistencën e marrëdhënies së përdorimit të këtyre pasurive nga shtetasi *** ***, në formën e një interesi privat. Gjithashtu nuk rezultojnë të ketë deklaruar shpenzime/investime apo të ardhura të realizuara lidhur me këto pasuri, ndërkohë që referuar deklaratimeve të vetë subjektit, duket se janë krijuar të ardhura, më

¹¹ Referohuni analizën financiare në f. 37 të vendimit të Komisionit.

¹² Referuar Rekomandimit të ONM-së, f. 6, pamjaftueshmëria rezultojnë në vlerën -235.435 lekë për vitin 2010 dhe -3.001.912 lekë për vitin 2012. Ndërsa po ti referohemi analizën financiare në faqen 37 të vendimit të Komisionit dhe të llogarisim vlerën e këtyre pasurive sipas çmimeve të referencës sikurse cituar në kontratat respektive do të rezultonte mungesë burimesh të ligjshme në masën - 2,265,425 lekë për vitin 2010 (duke zbritur dhe të ardhurat e bashkëshortit të subjektit si ristorator në vijim të arsyetimit të bërë në këtë parashtrësë) dhe në masën dhe -3.001.912 lekë për vitin 2012.

së paku, në natyrë, për subjektin dhe personin e lidhur, duke u ndodhur kështu në kushtet e një deklarimi të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

2.4 Lidhur me konfliktin e interesit, vlerësojmë se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj nuk janë bindëse, *pasi mosreferimi në kërkesën e dorëheqjes të rrethanave të plota, lidhur me marrëdhënien me karakter pasuror mes shitësve të pasurive dhe bashkëshortit të saj, më së paku, pamundëson vlerësimin e drejtë të titullarit, mbi situatën e mundshme të konfliktit të interesit*¹³. Gjithashtu, duhet mbajtur në konsideratë edhe fakti se pasuria e blerë nga bashkëshorti i subjektit nga këta shtetas ka një vlerë disa herë më të ulët se çmimi i referencës.

2.5 Në përfundim, lidhur me pasuritë tokë bujqësore “Arë”, për sa më sipër analizuar, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, vlerësojmë se rrethanat e konstatuara lidhur me këto pasuri e vendosin subjektin e rivlerësimit ***para një deklarimi të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe në kushtet e konfliktit të interesit***, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

3 Likuiditetet cash

3.1 Lidhur me likuiditetet cash, vlerësojmë se edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 10.7.2024 dhe në parashtrimet e datës 13.3.2025, pasi mbeti i paprovuar mbulimi me burime të ligjshme i kursimeve cash të deklaruara nga personi i lidhur në deklaratën para fillimit të detyrës në shumën 70.000 euro dhe si rrjedhojë nuk u provua as mbulimi me burime të ligjshme i kursimeve cash në shumën 10.000 euro të deklaruara në deklaratën *Vetting*¹⁴.

3.2 Subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, lidhur me burimet e krijimit të likuiditeteve cash në shumën 70.000 euro, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe nuk ka paraqitur akte të reja për të provuar të kundërtën e shkaqeve të ankimit.

3.3 Subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka pretenduar të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme të ardhurat e analizuar më sipër në kuadër të pasurisë “Apartament me sipërfaqe 111.6 m²”, si dhe ka kërkuar të përfshihen në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga avokatia për periudhën 2007-2009, në shumën 5.176.680 lekë. Gjithashtu, subjekti në parashtrimet e saj ka paraqitur analizën financiare për periudhën 1995 deri në **.3.2009 në dy variante.

3.4 **Drejtuksi i Prokurorisë së Posaçme**, fillimisht çmon të sjellë në vëmendje të Kolegjit, se pasuritë e deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI në datë **.3.2009, ku përfshihen dhe kursimet cash, janë krijuar gjatë bashkëjetesës së subjektit me personin e lidhur, ndërkohë që subjekti kishte ushtruar për disa vite funksionin e gjyqtarës.

¹³ Ndryshe nga sa subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në kërkesën për dorëheqje të vitit 2021, kohë në të cilin kishte filluar procesi i rivlerësimit.

¹⁴ Në analizën financiare përfundimtare të Komisionit, rezulton se subjektit ka një bilanc për periudhën shkurt 2009 – 2016, me vlerë negative -152,147 lekë. Ndërsa, analiza përpara fillimit të deklarimit të vitit 2009 rezulton me pamundësi financiare në vlerën -11,902,960 lekë.

3.5 Sikurse është trajtuar gjerësisht më sipër, lidhur me burimet e krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 111.6 m², vlerësojmë se nuk duhen konsideruar si burime të ligjshme për efekt të procesit të rivlerësimit të subjektit: (i) Të ardhurat e personit të lidhur nga shitja e shoqërisë “****” S.N.C., në Itali; (ii) Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit si ristorator për periudhën 2005–2011; (iii) Të ardhurat nga akt marrëveshja me nr.*** datë **.2.1997 për shitjen e pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit, Vlorë, (iv) si dhe të ardhurat e personit të lidhur nga paga në emigracion në Itali, pasi nuk rezulton mundësi kursimi nga këto të ardhura.

3.6 Përveç sa më sipër arsyetuar, referuar dhe analizës financiare të paraqitur nga subjekti në parashtrimet e datës 13.3.2025 vlerësojmë se:

3.6.1 Nuk duhen përfshirë në analizën financiare të ardhurat e subjektit nga punësimi si gjyqtare në vitet 1995-2002 pasi në deklaratat periodike për vitet 2003 dhe 2004 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime cash me burim këto të ardhura përveç kursimeve në llogarinë bankare në Bankën e Kursimeve në shumën 400.000 lekë.

3.6.2 Nuk duhen përfshirë në analizën financiare të ardhurat e subjektit nga avokatia përtej vlerës së paraqitur në analizën e Komisionit në vendimin nr.*/2024, pasi të ardhurat e pretenduara si të përfituara për periudhën 2004-2006, nuk konfirmohen nga organet tatimore.

3.7 Në përfundim të sa më sipër, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me kursimet cash dhe ndodhet në kushtet e nenit 61 pika 3 të ligjit nr.84/2016.

3.8 Pamjaftueshmëria financiare e rezultuar për periudhën 1.1.2005 - 6.2.2009 (data e rikthimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit) afekton jo vetëm kursimet cash por edhe pasuritë e tjera të krijuara deri në datën **.2.2009 dhe të deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës, përfshirë këtu edhe dy huat në shumën 17.000 euro dhe 3.000.000 lekë, deklaruar si burime krijimi për pasuritë e krijuara nga subjekti dhe personi i lidhur pas vitit 2009.

4 Hua në vlerën 17.000 euro, dhënë shtetases ** *, deklaruar si burim krijimi për pasurinë “Automjet tip Daimler Chrysler C270 CDI”.***

4.1 Lidhur me huan në vlerën 17.000 euro, dhënë shtetases *** ***, deklaruar si burim krijimi për pasurinë “Automjet tip Daimler Chrysler C270 CDI”, vlerësojmë se edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 10.7.2024 dhe në parashtrimet e datës 13.3.2025, lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të kësaj huaje dhe si rezultat mbeti i paprovuar mbulimi me burime të ligjshme i pasurisë “Automjet tip Daimler Chrysler C270 CDI”.

4.2 Subjekti i rivlerësimit edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe nuk ka paraqitur akte të reja për të provuar të kundërtën e shkakut të ankimit.

4.3 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë automjet, si dhe nuk ka deklaruar as kthimin e huas nga znj. *** **.

4.4 Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme pasuritë e deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009, përfshirë këtu dhe kursimin e shumës 17.000 euro të deklaruar si të dhënë hua shtetases *** **.

4.5 Deklarata noteriale e datës **.3.2015, nënshkruar nga subjekti dhe motra e saj, ku deklarohet kthimi i huas në shumën 17.000 euro në qershor të vitit 2009, rezulton të jetë hartuar disa ditë pas mbajtjes së procesverbalit pranë ILDKPKI-së (datë **.2.2015) dhe 6 vite pas kthimit të pretenduar të huas, duke krijuar bindjen se është hartuar gjatë kontrollit nga ILDKPKI-ja, për të provuar se subjekti i rivlerësimit kishte të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë “Automjet tip Daimler C270”.

4.6 Duke përfunduar, **Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme**, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së datë 28.6.2024, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me shumën 17.000 euro, dhënë hua shtetases *** ** dhe si rezultat ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për pasurinë automjet tip ‘Daimler Chrysler C270 CDI’, që deklarohet me burim krijimi kthimin e kësaj huaje.

5 Apartament banimi me sip. 134.5 m², ndodhur në Tiranë

5.1 Lidhur me huanë në shumën 3.000.000 lekë, deklaruar si huadhënie në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009 dhe në vijim deklaruar si burim krijimi për pasurinë apartament banimi me sip. 134.5 m², ndodhur në Tiranë, vlerësojmë se edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 10.7.2024 dhe në parashtrimet e datës 13.3.2025, lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të kësaj huaje.

5.2 Subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, ndër të tjera ka deklaruar se gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, është verifikuar huadhënia e cila ka rezultuar e deklaruar saktësisht dhe bazuar në burime të ligjshme. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se pavarësisht se konsideron se kjo çështje nuk i përket juridiksionit të rivlerësimit për sa kohë nuk ka dyshime për deklarim të pasaktë apo të pavërtetë në deklaratën *Vetting*, ka paraqitur në cilësinë e provës aktet si vijon: (i) vërtetimin nr.** prot., datë **.2.2025, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për të ardhurat e realizuara prej saj në periudhën 2019-2022; (ii) Shkresën nr.**/* prot., datë **.2.2025 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, për të ardhurat e realizuara nga Personi Fizik “**** **” për periudhën 2019-2022; (iii) dhe vërtetimin nr.**, datë **.2.2025 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, ku referohet se tatimpaguesi *** ** nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri në datën **.2.2025.

5.3 **Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme**, fillimisht thekson se bazuar në kuadrin ligjor që normon procesin e vettingut, si dhe jurisprudencën e Kolegjit, mbajmë në konsideratë se analiza e shpenzimeve të kryera pas dorëzimit të Deklaratës *Vetting*, mund të ketë relevancë për procesin e rivlerësimit në rrethana specifike. Kolegji ka interpretuar në jurisprudencën e tij se, nëse një subjekt rivlerësimi do të justifikonte kryerjen e shpenzimeve pas vitit 2016 (pas dorëzimit të Deklaratës “Vetting”), me të ardhura të padeklaruara apo të pretenduara të akumuluar deri në momentin e dorëzimit

të Deklaratës *Vetting*, do të ishte e arsyeshme analiza nga Komisioni [ose Kolegji] në kushtet kur krijohet dyshimi për deklarim të pasaktë dhe të pavërtetë në Deklaratën *Vetting*¹⁵.

5.4 Aktet e sipërcituara të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore të datës 13.3.2025, referojnë të ardhura të realizuara nga subjekti dhe personi i lidhur përgjatë periudhës 2019-2022 dhe nuk ndikojnë në konstatimin lidhur me huan në shumën 3.000.000 lekë, deklaruar dhënë shtetasit *** *** në deklaratën para fillimit të detyrës dhe që pas kthimit në vitin 2016 ka shërbyer si një nga burimet e krijimit të pasurisë *apartment banimi me sip. 134.5 m², ndodhur në Tiranë*.

5.5 Sa më sipër, vlerësojmë se, për sa kohë nuk provohet mbulimi me burime të ligjshme i huadhënies në shumën 3.000.000 lekë, nuk mbulohet plotësisht me burime të ligjshme dhe pasuria “*Apartment banimi me sip. 134.5 m², ndodhur në Tiranë*”, për të cilën si burim krijimi ka shërbyer dhe huaja e sipërcituar.

6 Shoqata “****”

6.1 Lidhur me rrethanat e konstatuara për shoqatën “****”, me drejtor ekzekutiv znj. *** *** (*motra e subjektit të rivlerësimit*) dhe me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e një prej anëtarëve themelues, rezulton se në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, nuk u provua që personi i lidhur të ketë realizuar të ardhura apo përfitime nga të qënit anëtar themelues i kësaj shoqate.

6.2 Sa më sipër, **Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme**, vlerëson se lidhur me këtë shkak ankimi *nuk u evidentuan rrethana të tilla që do të ndikonin në procesin e rivlerësimit të subjektit znj. Mirela Mishgjoni*.

7 Në përfundim, në analizë të provave dhe akteve të administruara, **Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme** vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016. Sa më sipër, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 dhe 5 e aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 61, pika 3 dhe 5 e ligjit nr. 84/2016.

¹⁵ Referohuni vendimit (JR) nr. 8/2021, prg. 26.3.

II. KËRKIMI PËRFUNDIMTAR

8 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 10.7.2024 dhe parashtimeve të datës 13.3.2025, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, pikës 2, të nenit 4, pikës 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit Nr. 754, datë 5.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni.

DREJTUESI I PROKURORISË

Altin DUMANI

PROKURORI I AUTORIZUAR

Adnan XHOLI